

VENDIM
Nr. 106, datë 29.6.2016

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË “RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR
TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 16; 81, pika 2; 99 dhe 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s dhe vendimit nr. 102, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a., lidhur me mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, shërbimet ndihmëse dhe disbalancat”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me miratimin e një ndryshimi në “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në “Rregullat e tregut”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, i ndryshuar, si më poshtë:

Në kapitullin IX. 1.3, germa “g”, bëhet si më poshtë:

g.1 “Duke filluar nga 1 korriku 2016, çdo pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike, me përjashtim të subjekteve të përcaktuara në ligjin nr. 138/2013, “Për burimet e rinovueshme dhe sipas pikës 4, të nenit 99, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike.”.

g.2 Klientët fundorë, që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal, nuk janë përgjegjës për disbalancat kundrejt këtij të fundit.

2. KESH sh.a. duke qenë sigurues i shërbimeve ndihmëse dhe balancimit, nuk do të jetë subjekt i disbalancave për periudhën e mbetur të vitit 2016.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti